

INFORMATATA PËR EMIGRANTË
MBI
PËRKTHIMIN E ÇËSHTJEVE TË
PËRDITSHME

Broshura të Ministrisë së Punës 2004
www.mol.fi/migration

Broshura është hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Lingua Nordica Oy:në, Qendrën e përkthimeve të çështjeve të përditshme të rrethit të Helsinkit, Qendrën e përkthimeve të Keski-Suomit, Qendrën e përkthimeve të Pirkanmaas, Shërbimet e përkthimit të Pohjois-Suomit dhe me Qendrën e përkthimeve të rrethit të Turkut.

Në këtë broshurë flitet shkurtimisht mbi përkthimin e çështjeve të përditshme dhe punën e përkthyesit si dhe jepen udhëzime për emigrantët mbi përdorimin e shërbimeve të përkthimit. Broshura gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Punës në adresën:
www.mol.fi/migration

INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI PËRKTHIMIN

Nevoja për përkthyes lind kur personat nuk kanë gjuhë të përbashkët komunikimi. Me anë të përkthyesit mundësohet komunikimi i rrjedhshëm dhe kuptimi i çështjeve të ndryshme pavarësisht pengesat gjuhësore dhe kulturore.

Me përkthim të çështjeve të përditshme kuptohet përkthimi i dialogut, psh i intervistës ose i marrjes në pyetje, midis nëpunësit dhe klientit. Ky lloj përkthimi mund të zhvillohet në mënyrë konsektive, pra përkthimi në gjuhën tjetër ndodh menjëherë pas ligjëratës, ose në mënyrë simultane, pra përkthyesi përkthen njëkohësisht gjatë ligjëratës së folësit. Përkthimi i çështjeve të përditshme ndodh ose duke patur praninë e përkthyesit në vend ose si përkthim në distancë ose me anë të telefonit apo videos.

Përkthyesi i çështjeve të përditshme zotëron përveç aftësive gjuhësore edhe aftësi në komunikim si dhe njohje të kulturave përkatëse. Përkthyesit janë shkolluar në profesionin e tyre, psh duke marrë diplomën profesionale të përkthimit të çështjeve të përditshme ose duke studiuar lëndën e përkthimit në universitet.

Detyra e përkthyesit është të përkthejë ligjëratat e folura. Përkthyesi nuk është ndihmës ose avokat i nëpunësit as ndihmës ose avokat i klientit emigrant. Kushërinjtë e afërt të personave që marrin pjesë në përkthim, miqtë ose fëmijët e tyre nuk mund të jenë përkthyes profesionistë.

Në punën e tyre përkthyesit zbatojnë rregulloren profesionale të përkthyesit të çështjeve të përditshme dhe udhëzimet përkatëse. Disa nga rregullat më të rëndësishme janë:

- Përkthyesi mban sekret të gjitha ato për të cilat flitet.

- Gjatë përkthimit përkthyesi është asnjëherë dhe nuk ndërhyr në çështjet e diskutuara. Qëndrimet ose opinionet personale të përkthyesit nuk influencojnë punën e tij.
- Përkthyesi nuk mund të përkthejë nëse në përkthim marrin pjesë, psh kushërinjtë e tij të afërt ose miqtë e tij. Në të tilla situata përkthyesi konsiderohet ligjërisht "i penguar".
- Përkthyesi përkthen gjithçka flitet. Ai nuk shton e as nuk heq asgjë nga sa flitet.
- Gjatë përkthimit përkthyesi nuk bën detyra të tjera përveç përkthimit.

GJATË PËRKTHIMIT VEPROHET SI MË POSHTË:

- Flisni qartë.
- Mos ju drejto përkthyesit kur të flisni. Ju po bisedoni me nëpunësin, jo me përkthyesin. Mos harroni se përkthimi bëhet në vetën e parë.
- Jepi kohë përkthyesit të përkthejë ligjëratën tuaj.
- Përkthyesi përkthen gjithçka. Pra flisni vetëm atë që dëshironi të përkthehet.

Nëpunësi dhe përkthyesi janë të pranishëm vetëm për një kohë të caktuar, prandaj është e rëndësishme të zbatohen oraret e takimeve.